



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 6 të Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe nenin 50 të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Vushtrrisë 01Nr. 67/15, datë 26.03.2015, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Ndalohet qarkullimi i mjeteve motorike të transportit të mallrave me peshë mbi 3.5 ton në qytet, në rrugët:
 - 1.1 „Vesli Klark”
 - 1.2 „Hasan Prishtina”
 - 1.3 „Isa Boletini”
 - 1.4 „Ruzhdi Hyseni”
 - 1.5 „Bislim Bajgora”
 - 1.6 „Basri Beqiri”
2. Ndalim qarkullimi sipas pikës paraprake të kësaj urdhërese vlen për ditët: e hënë – e shtunë, prej orës 10:00 deri 23:00
3. Drejtoria për Shërbime Publike obligohet që në afat sa më të shkurtër kohorë të vendosë shenjat e sinjalizimit vertikal të ndalim qarkullimit për rrugët e specifikuara dhe kohën e ndalim qarkullimit, të përcaktuar në pikën 1 (një) dhe 2 (dy) të kësaj urdhërese.
4. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të filloj të zbatohet menjëherë.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Urdhëresa iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Zyrës për Informim
- Arkivit të Sekretarisë